



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PEJË

Numri i lëndës: 2019:289527

Datë: 02.04.2024

Numri i dokumentit: 05535033

C.nr.2433/23

GJYKATA THEMELORE NË PEJË, Departamenti i përgjithshëm, me gjyqtarin Besnik Shala - në çështjen juridike kontestimore të paditësit: Sh.Z nga fshati O K.I, të cilin e përfaqëson av. A.M nga Peja, kundër të paditurës MBP në P – P.K, S.P P, të cilën e përfaqëson A. Sh, me objekt kontesti marrëdhënie pune, me vlerë të kontestit 31.491,43 Euro, në prezencën e të autorizuarës së paditësit dhe në mungesë të autorizuarit të paditurës, pas seancës se shqyrtimit kryesor të mbajtur, ndërsa me datë 02.04.2024, përpiloi këtë:

A K T G J Y K I M

APROVOHET në tersi si e bazuar kërkesëpadia e paditësit: Sh.Z nga fshati O Komuna e I, kundër të paditurës MBP në Prishtinë – P.K, S.P Pejë, ashtu që:

- I. **ANULOHET** Vendimi i të paditurës MBP në Prishtinë – P.K, S.P Pejë me nr. 1140/KPD/13i datës 18.12.2013 dhe vendimi i shkallës së dytë me numër 11-KA-D/2014 i datës 14.01.2014 për ndërprerjen e marrëdhënies së punës të paditësit Sh.Z nga fshati O. Komuna e I si të **KUNDËRLIGJSHËM**, ashtu që **DETYROHET** e paditura MBP në Prishtinë – P.K, S.P P që paditësin ta kthejë në vendin e tij të punës dhe në emër të kompensimit për ndërprerjen e kundërligjshme të marrëdhënies së punës nga data janar 2011 e deri me janar 2019, të i paguajë pagat bruto për periudhën e larguar nga marrëdhënia e punës në shumë prej 31.491,43 euro, me kamat ligjore prej 8%, nga data 27.11.2023 (dita e përpilimit të ekspertizës), e deri në pagesën definitive e të gjitha këto në afat prej 7 dite nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi e nën kërcënim të përmbartimit të dhunshëm
- II. **DETYROHEN** të paditura MBP në Prishtinë – P e K, S.P P, që paditësit Sh.Z nga fshati O.K I, ti paguaj shpenzimet e procedurës kontestimore në lartësi prej 1.498,00 euro, e të gjitha këto në afat prej 7 dite, nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi e nën kërcënim të përmbartimit të dhunshëm.

A r s y e t i m

Paditësit pranë kësaj gjykate ka parashtruar padi me datë 12.02.2014, të precizuar me parashtrësën e datës 07.12.2023, kundër të paditurës me objekt kontesti marrëdhënie pune, me vlerë të kontestit 31.491,43 Euro.

E autorizuar e paditësit sipas parashtrësës së dt. 07.12.2023 dhe në fjalën e saj përfundimtare deklaroi: qëndrojmë pranë e padisë dhe kërkesës se sajë si dhe precizimit të dt. 07.12.2023 dhe rregullimit në seancën e sotme, me provat e administruara është vërtetuar në tersi besueshmëria e kërkesës në padi ashtu që paditësit i është shkëput marrëdhënia e punës si në vendimin me nr. 11-KA-D/2014 për tri shkelje disiplinore e këto shkelje në krejt arsytimin e vendimit bazohen në aktin akuzues që e kanë largu paditësin nga marrëdhënia e punës, i njëjti për tërë atë arsytim gjykatës i ka dorëzuar dy vendime penale nga shkalla e parë dhe e dytë dhe atë aktgjykimi PKR.nr. 539/12 i GJTH-Prishtinë, dhe aktgjykimi i PAKR.nr. 566/2019 nga Gjykata e Apeli, andaj i propozojmë gjykatës që padia dhe kërkesa e sajë të aprovohet në tersi si e bazuar, të anulohen vendimet me nr. 1140-KPD/13 i Komisionit të brendshëm hetimor në kuadër të ministrisë së punëve të brendshme i dt. 18.12.2013 dhe vendimi 11-KA-D/2014 të detyrohet e paditura që paditësin në afat prej 7 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë ta shpërblejë demin për pagat e humbur në shumën si në ekspertizë dhe në plotësimin e saj, dhe të ia kompensojë të gjitha shpenzimet procedurale sipas parashtrësës për shpenzimet e dt. 07.12.2023, duke shtuar edhe seancës e sotme që në tërësinë arrin vlerën në shumë prej 2,122.00 euro.

Gjykata në kuptim të nenit 423 paragrafi 4 të LPK-se, e sipas propozimit të autorizuarës së paditësit, seancën e shqyrtimit kryesor të dt. 29.02.2024, e ka mbajtur në mungesë të autorizuarit të paditurës, pasi që i njëjti ishte i ftuar në mënyrë të rregullt, dhe ftesës nuk i është përgjigjur e as mungesën nuk e ka arsyetuar.

E autorizuar e të paditurës me përgjigje në padi dhe gjatë shqyrtimit gjyqësor ka deklaruar: e kundërshtojmë në tersi padinë dhe kërkesën e saj pasi që Drejtoria e Përgjithshme e P ka nxjerr vendimin sipas nr. Lëndës 11-KA-D/2014, me të cilin ka lënë në fuqi vendimin e komisionit të brendshëm disiplinore lidhur me masën e shqiptuar ndërprerje e marrëdhënies së punës, ku paditësi është shpallur fajtor për shkak të shkeljeve disiplinore nga kreu II neni 5 pika 7, neni 5 pika 12, neni 9 pika 4, të bazuara në udhëzimin administrativ nr. 15/2008 dhe lidhur me nenin 46 pika a) e Ligjit për P e K. Për çka i ka propozua gjykatës që padinë e paditësit ta refuzoj në tersi si të pa bazuar.

Gjykata konstaton se kjo lëndë sipas Aktvendimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës me Ac. nr. 10689/2021 i datës, 25.07.2023, është aprovuar si e bazuar ankesa e paditësit, ndërsa Aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Pejë, C.nr. 1534/19 i datës 05.11.2021, është prishur dhe lënda i është kthyer kësaj gjykatë në rishqyrtim dhe vendosje.

Gjykata në këtë çështje juridike - kontestimore me qëllim të vërtetimit të plotë të gjendjes faktike, sipas udhëzimeve të Gjykatës së Apelit, në ri procedurë ka caktuar shqyrtimin kryesor, dhe sipas propozimit të palëve ka zhvilluar procedurën dhe ka administruar provat ku me propozimin e të autorizuarave të palëve ndërgjyqës janë konstatuar si të lexuara të gjitha provat (shkresat e lëndës) të cilat janë administruar me parë, (në shqyrtimin paraprak C.nr. 1354/19 i datës 22.10.2021), Vendimi i komisionit të brendshëm disiplinor me nr. 1140/KBD/13, aktgjykimi PKR.nr.539/12 i GJTH-Prishtinë, aktgjykimi i PAKR.NR.566/2019 nga Gjykata

Apelit, plotësimi i ekspertizës financiare i dt.27.11.2023, certifikata e Sh.Z për trajnim për ricertifikim, certifikate e Sh.Z për trajnim të avancuar e hetim të Krimin, mirënjohja për policin Sh.Z, certifikata e Sh.Z për trajnimin e intervistimit të kriminelëve, certifikata e Sh.Z për trajnimin e taktikave speciale, lista e distributimit me nr. të referencës ZVDP-02/01/ZL-0045/2024 me të gjitha raportet dhe vendimet e bashkangjitura në të, si dhe deklaratimet e të autorizuarve të palëve ndërgjyqësve.

Pasi që gjykata bëri vlerësimin e secilës provë veç e veç, dhe të gjitha së bashku në lidhmëni me njëra tjetrën, e duke u mbështetur në dispozitat e nenit 8, të Ligjit për Procedurën Kontestimore, gjykata erdhi në përfundim se në këtë çështje juridiko – kontestimore duhet vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Mes palëve ndërgjyqës nuk ishte kontestuese fakti se paditësit i është ndërprerë marrëdhënia e punës me vendimin nr. 1140/KDB/13. I cili vendim ishte vërtetuar me vendimin e Komisionit për Ankesa dhe Shpërblime me nr. 11-KA-D/2014 të datës 14.01.2014.

Kontestues mes palëve ndërgjyqës ishte çështja e ligjshmërisë së vendimit të të paditurës për ndërprerjen e marrëdhënies së punës, çështja se këtë vendim e paditura e ka marrë duke u bazuar në faktin se ndaj paditësit është ngritur aktakuza penale, dhe se pretendimet tjera të cekura në vendimin kontestues janë të pa bazuara në ligj dhe janë të përfshira me shkelje të dispozitave ligjore të ligjit për policin, kontratës kolektive dhe ligjit të punës.

Gjykata sipas propozimit të autorizuarës së paditësit dhe sugjerimeve të dhëna nga Gjykata e Apelit kishte bërë dëgjimin e paditësit Sh.Z në cilësi të palës ku i njëjti në seancën e datës 29.02.2024 kishte deklaruar se: me dt.16.12.2011, unë jam thirri në stacionin policor në Pejë, dhe me kanë thënë se jam i dyshuar në një vepër penale në ç ‘rast jam arrestuar ku kam qëndruar për 3 muaj në paraburgim që i bije diku nga dt.16.04.2012, dhe në kohën kur jam arrestuar më është dhënë një vendim për suspendim nga puna dhe ky suspendim ka vazhduar diku deri në vitin 2013, dhe befasisht një ditë më kanë thirrur duke me thënë se duhet të kthehesh në punë, me ç ‘rast jam lajmëruar në stacion i kam marrë rrobat dhe ia kam filluar punën, gjatë kohës sa kam filluar punë më ka thirrur njësi standarde profesionale e cila merret me shkeljet disiplinore në kuadër të policisë së Kosovës, ata e kanë hetuar lëndën lidhur me veprën penale të cilën jam hetuar, unë kam jap deklarata në këtë njësi me pas ata më kanë dhënë një propozim i cili ka kaluar tek një komision i cili ka qenë i përberë nga zyrtaret policor, ata më kanë jap një vendim me pas rreth 6 muaj përafërsisht sa kam qenë duke punuar ku kanë aprovuar kërkesën e standardeve profesionale për largim nga puna, pas kësaj jam ankuar në një shkallë më të lartë në të dytën brenda policisë të cilën e kam bërë vetëm me shkrim, ku këta kanë vërtetuar vendimin e shkallës së parë duke e lënë të njëjtin në fuqi duke ma ndërprerë marrëdhënien e punës, pas largimit nga puna jam paraqitur në gjykatën penale në vitin 2019, ku kjo gjykatë më ka liruar nga akuzat në të dyja shkallët dhe ajo e apelit për veprën penale për të cilën jam akuzuar.

Gjykata duke i pasur parasysh sugjerimet e Gjykatës së Apelit është kërkuar plotësimi i ekspertizës financiare e punuar nga eksperti U.S ku i njëjti në plotësimin e datës 27.11.2023 kishte konstatuar se nga provat të cilat gjinden në shkresa të lëndës dhe provat shtesë që i kishte

siguruar eksperti dhe atë pasqyrën e TRUST-it për paditësin dhe nga i njëjti konstatohet se paditësi nga janari 2014 deri me janar 2019 nuk ka qenë në marrëdhënie pune e ku nga muaji shkurt i vitit 2019 është në marrëdhënie pune në K. Regjionale të Mbeturinave “Pastrimi” Sh.a. Prishtinë, dhe gjatë periudhës janar 2014 deri me datën janar 2019 paditësi do të inkasonte shumen dhe atë pagën bruto prej 31.496,43 euro, nga e cila shumë ndalen në burim kontributi pensional në shumë prej 1,574,82 euro, që rezulton pagën neto në shumë prej 28.281.81 euro, e ku obligim i paditurës është që shumen prej 1.574,82 euro të përfundojë në Fondin e Trustit pensional nga llogaria e punëdhënësit në të mirë të llogaris së paditësit.

Gjykata ekspertizës financiare, i ka falur besimin në tërësi, pasi që e njëjta është përpiluar konform detyrave të dhëna nga gjykata, ka përmbajtur informata të mjaftueshme e të cilat eksperti i ka sqaruar dhe në shqyrtim gjyqësor, duke dhënë sqarime shtesë. Duhet shtuar se edhe e autorizuar e palës paditëse nuk kishte vërejtje në këtë ekspertizë ndërsa pala e paditur nuk është deklaruar fare për të njëjtën

Gjykata nga provat e administruara ka vërtetuar faktin se paditësit i është ndërprerë marrëdhënia e punës me vendimin nr. 1140/KDB/13. Ku në bazë të këtij vendimi paditësit i është shqiptuar masa disiplinore ndërprerje e marrëdhënies së punës për shkak se i njëjti është gjetur fajtor se me veprimet e tij ka bërë shkelje disiplinore nga kreu II neni 5 pika 7, neni 5 pika 12, neni 9 pika 4, neni 9 pika 6, të bazuara në udhëzimin administrativ nr. 15/2008 e lidhur me nenin 46 pika a) dhe e) të Ligjit për Policin.

Paditësi pas pranimit të vendimit me nr. 1140/KDB/13 ka parashtruar ankesë pranë Komisionit për Ankesa dhe Shpërblime, komisioni me vendimin nr. 11-KA-D/2014 të datës 14.01.2014, ka refuzuar ankesën e ankuesit këtu paditësit duke e lënë në fuqi vendimin nr. 1140/KDB/13.

Fillimisht, gjykata thekson se në këtë çështje si ligj i aplikueshëm është Ligji Nr. 03/L-212 i Punës, i cili është në fuqi nga data 16.12.2010. Sipas këtij ligji, konkretisht nenit 78 par. 1. *“I punësuar i cili vlerëson se punëdhënësi ka shkelur të drejtën e marrëdhënies së punës, mund të paraqesë kërkesë të punëdhënësi apo organi përkatës i punëdhënësit nëse ekziston, për realizimin e të drejtave të shkelura, par.2. Punëdhënësi është i obliguar për të vendosur sipas kërkesës së të punësuarit, në afatin brenda pesëmbëdhjetë (15) ditëve nga data e pranimit të kërkesës. Par. 3. Vendimi nga paragrafi 2. i këtij neni, i dorëzohet të punësuarit në formë të shkruar brenda afatit prej tetë (8) ditësh”.*

Me neni 79 të Ligjit të Punës, është parapare mundësia e të punësuarit që të atakojë vendimin përfundimtar në gjykatë *“Çdo i punësuar i cili nuk është i kënaqur me vendimin me të cilin mendon se i janë shkelur të drejtat e tij, ose nuk merr përgjigje brenda afatit nga neni 78 paragrafi 2. të këtij ligji, në afatin vijues prej tridhjetë (30) ditësh, mund të iniciojë kontest pune në Gjykatën Kompetente”.*

Kurse në neni 80, të Ligjit të Punës, janë të përcaktuara kompetencat e gjykatës në rastin kur konstaton se marrëdhënia e punës është ndërprerë në mënyrë të kundërligjshme/ Vendosja

gjyqësore lidhur me ndërprerjen e kontratës së punës 1. *“Nëse gjykata konstaton se ndërprerja e kontratës së punës nga ana e punëdhënësit është joligjore, në bazë të dispozitave të këtij ligji, Kontratës Kolektive ose Kontratës së Punës, atëherë do të urdhërojë punëdhënësin që të ekzekutoj njërën prej këtyre dëmshpërblimeve: 1.1. t’i paguajë të punësuarve kompensimin, përveç shtesave dhe shumave tjera të cilat i takojnë punonjësit në bazë të këtij ligji, Kontratës së Punës, Kontratës Kolektive ose Aktit të Brendshëm, në shuma të tilla që gjykata i konsideron të drejta dhe adekuate, por të cilat nuk duhet të jenë më pak se dyfishi i vlerës së çdo dëmshpërblimi që i takon punonjësit në kohën e shkarkimit..”*

Deri të marrja e vendimit të lartcekur e paditura ka ardhur pasi që ka gjetur se këtu paditësi gjatë periudhës kohore gusht-tetor të vitit 2011, kishte qenë i involvuar në veprimtari kriminale “krim i organizuar” blerje, posedim, transportim, shpërndarje dhe shitje e pa autorizuar e narkotikeve të rrezikshëm dhe të substancave psikotrope”, “trafikim me njerëz” dhe “falsifikim i dokumenteve”. Me datë 16.12.2011, këtu paditësi nga Drejtoria për hetim të trafikimit të narkotikeve pranë divizionit Kundër Krimin të Organizuar- DKKO, në Prishtinë ishte arrestuar dhe dërguar në qendër të paraburgimit ku kishte qëndruar deri me datë 26.03.2012, këtu paditësi në po të njëjtën ditë ishte suspenduar nga detyra zyrtare lidhur me rastin e lartcekur për veprimtari penale dhe për të njëjtat vepra ishin arrestuar edhe persona tjerë. Dhe me datë 17.12.2011, ndaj këtu paditësit është ngritur kallëzim penalë në Prokurorin e Qarkut të Prishtinës. Me këto veprime paditësi ka kryer shkelje disiplinore nga kreu II neni 5 pika 7, neni 5 pika 12, neni 9 pika 4, neni 9 pika 6, të bazuara në udhëzimin administrativ nr. 15/2008 e lidhur me nenin 46 pika a) dhe e) të Ligjit për Policin dhe atë duke u bazuar në provat të cilat i janë bashkangjitur shkresave të lëndës për procedurën disiplinore.

Gjykata sipas sugjerimit të gjykatës së apelit nga e paditura kishte kërkuar dosjen disiplinore me aktvendimin e datës 23.01.2024, dhe nga e paditura kishte pranuar dosjen edhe pse të gjitha provat e dorëzuara nga e paditura gjendeshin në shkresa të lëndës.

Me aktgjykimin PAKR.nr. 566/19, të Gjykatës së Apelit të Kosovës me të cilin është vërtetuar aktgjykimin PKR. 539/12 i datës 11.06.2019, i Gjykatës Themelore në Prishtinë, me të cilin aktgjykim këtu paditësi dhe të gjithë të akuzuarit tjerë të cilit ishin në atë lëndë janë liruar nga aktakuza.

Nga të gjitha provat e administruara gjykata gjeti se kërkesë padia e paditësit është e bazuar kjo për faktin se Udhëzimi Administrativ me nr. 15/2008- MPB për Llojet e Shkeljeve të Renda dhe të Lehta Disiplinore në P.K. Janë përcaktuar shkeljet e në rastin konkret këtu e paditura me vendimet e atakuar nga ana e paditësit, kur i është ndërprerë marrëdhënia e punës i është referuar tri rrethanave dhe atë 1) *“gjatë periudhës gusht – tetor të vitit 2011 i akuzuari Shefqet Zogaj kishte qenë i involvuar në veprimtari penale krim i organizuar, blerje posedim, transportim, shpërndarje dhe shitje e pa autorizuar e narkotikeve të rrezikshëm dhe të substancave psikotropike, trafikim me qenie njerëzore dhe falsifikim i dokumenteve”* dhe në arsyen e 2) *me datë 16.12.2011, ndaj të akuzuarit Shefqet Zogaj nga Drejtoria e Hetimit të Trafikimit të Narkotikve, pranë DKKO, në Prishtinë, ishte arrestuar dhe dërguar në qendrën e paraburgimit ku kishte qëndruar deri me datën 26.03.2012,*” dhe arsyeja e 3) *“me datë*

17.12.2011, ndaj të akuzuarit Sh.Z ishte ngritur Kallëzimi Penal në Prokurorin Publike të Qarkut në Prishtinë” pra marrëdhënia e punës paditësit i shkëputet për këto arsye e duke u bazuar në nenin 5 pika 7 i cili përcakton se “shoqërohet apo mban raporte afërta me persona të cilët janë nën hetime apo të shpallur fajtor për vepra të rënda penale, përpos rastit kurë punonjësit e policisë janë caktuar në detyrë në pajtim me legjislacionin në fuqi, apo për shkak të lidhjeve të ngushta familjare me personat nën hetime apo të shpallur fajtor”, ndërsa neni 5 pika 12 parasheh “sillet në mënyrë duke i ven hije të keqe apo të turpshme p.k gjatë kryerjes së detyrave apo jashtë saj”, neni 9 pika 4 parasheh ”pa ndonjë arsye nuk raporton menjëherë tek mbikëqyrësi i tij për çfarë do veprave penale apo informacion të rëndësishëm për zbulimin e veprave penale apo kryesve të tyre apo për ndonjë ndalim apo arrestim të personit” dhe nenin 9 pika 6 keqpërdor autoritetin e Policisë për përfitime personale apo financiare, ose për përfitimin e privilegjeve të cilat nuk mund ti kenë në dispozicion përveç kur kryen detyrat e tyre ose për shmangien nga pasojat e veprave të kundërligjshme, përveç në ato raste kur kërkohet prej tyre në mënyrë legjitime ta përdorin ndikimin apo autoritetin e tyre”.

Mbi bazën e dispozitave të lartcekura e paditura ka zhvilluar procedurën disiplinore ndaj paditësit dhe ka konstatuar shkelje të rënda disiplinore, për çka edhe të njëjtit i është ndërprerë marrëdhënia e punës me arsyet si ne vendimin e atakuar. Mirëpo duke pasur parasysh se vendimi mbi shkëputjen e marrëdhënies se punës ndërlidhet me veprimet e ndërmarra nga paditësi e ku te njëjtat nuk kanë rezultuar si vepër penale për çka këtu paditësi me Aktgjykimin PKR.nr. 539/12 të datës 11.06.2019, e i cili aktgjykim është vërtetuar nga Gjykata e Apelit me aktgjykimin PAKR.nr. 566/2019 të datës 18.11.2019, pra pala e paditur i referohet faktit se : 1) paditësi kishte qen i involvuar ne veprimtari kriminale, 2) paditësi Sh.Z është arrestuar me datë 16.12.2011 e ku ka qëndruar në paraburgim deri me datë 26.03.2012, dhe 3) ndaj paditësit me datë 17.12.2011 është ngritur kallëzim penal, pra të gjitha këto arsye janë të lidhura me veprën penale e qe në këtë situatë për te gjitha këto veprime këtu paditësi është liruar nga akuza,

Dhe gjithashtu pretendimi i paditurës se paditësi është shoqëruar me persona të kriminalizuar e në rastin konkret të njëjtit janë liruar nga veprat penale që ju vihen në barrë sipas Aktgjykimin PKR.nr. 539/12 të datës 11.06.2019, e i cili aktgjykim është vërtetuar nga Gjykata e Apelit me aktgjykimin PAKR.nr. 566/2019 të datës 18.11.2019, për çka pala e paditur nuk ka argumentuar me asnjë provë të vetme se paditësi ka ber shkeljet te cilat i vihen në barrë.

Gjithashtu vendimi i marr nga e paditura është në kundërshtim me nenin 85 par.1 të ligjit të punës ku është përcaktuar “për shkelje të detyrave të punës të punësuarit do t’i shqiptohet njëra nga këto masa: ndërsa pika 5 përcakton ndërprerje të marrëdhënies së punës “ për më tepër në paragrafin 3 të këtij neni përcaktohet “Masat ndëshkuese, suspendimi i përkohshëm dhe ndërprerja e marrëdhënies së punës, do të shqiptohen për shkelje të rënda të detyrave të punës në pajtim me Kontratën Kolektive, Aktin e Brendshëm të Punëdhënësit dhe Kontratën e Punës” e që në rastin konkret e paditura gabimisht ka gjetur se paditësi me veprimet e tije ka bërë shkelje disiplinore nga kreu II neni 5 pika 7, neni 5 pika 12, neni 9 pika 4, neni 9 pika 6, të bazuara në udhëzimin administrativ nr. 15/2008 e lidhur me nenin 46 pika a) dhe e) të Ligjit për Policin, pasi që për të gjitha ato veprime të cilat i vihen në barrë paditësit sipas vendimit nr.

1140/KDB/13, i njëjti është liruar me aktgjykim të formës së prerë dhe nuk ka dëshmi tjera se për ndonjë veprim tjetër të ndërmar nga paditësi që do të i shkëputet marrëdhënia e punës.

Gjykata konstaton se e paditura me rastin e marrjes së vendimit nr. 1140/KDB/13 me të cilin i është ndërprerë marrëdhënia e punës këtu paditësit, dhe nga këto rrethana të cekura me lartë, e duke u bazuar në dispozitat e lartcekura të Udhëzimit Administrativ me nr. 15/2008-MPB për Llojet e Shkeljeve të Renda dhe të Lehta Disiplinore në P.K, dhe Ligjit për P me nr. 03/L-035, vendimin e bëjnë të kundërligjshëm.

Dhe gjithashtu pretendimet e të paditurës të theksuar si në vendimin 11-KA-D/2014 të datës 14.01.2014, me an të cilit i është refuzuar ankesa të paditësit e paditura nuk jap ndonjë arsye shtesë apo ndonjë argument me anë të cilit do të vërtetohet se paditësi ka kryer shkelje disiplinore pasi që arrestimi i tij caktimi i paraburgimit dhe ngritja e kallëzimit penal nuk nënkuptojnë se i njëjtit në mënyrë të drejtpërdrejt është edhe fajtor pasi që duke u bazuar edhe në raportin përfundimtar i hetimeve me nr. 680-PK-2013 janë gjetur te njëjtat veprime në bazë të cilave i është ngritur kallëzimi penal.

Pala e paditur nuk ka paraqitur asnjë provë me anë të cilave do të vërtetoheshin pretendimet e paraqitura gjatë procedurës, pretendime për çka i njëjta nuk ka ofruar asnjë prove që do të vërtetonte të kundërtën, e duke u bazuar në nenin 322 paragraf 1 dhe 2 e lidhur me neni 7 paragraf 1 dhe 319 paragraf 1 të LPK-së, e në anën tjetër gjykatës i ka munguar autorizimi që të nxjerr prova sipas detyrës zyrtare sepse me nenin 7 paragraf 2 të LPK-së, përcaktohet se: “Gjykata mund të kërkoj nxjerrjen e provave sipas detyrës zyrtare, për vërtetimin e fakteve edhe pse palët nuk i kanë propozuar, vetëm nëse ato prova po që se nga rezultati i shqyrtimit dhe i të provuarit del se palët kanë për qëllim disponimin me kërkesat me të cilat nuk mund të disponojnë lirisht të përcaktuara në kuptim të nenit 3 paragraf 3 të LPK-së”.

Sa i përket lartësisë së kontestit, me të cilën gjykata ka aprovuar kërkesëpadinë e paditësit, ka vepruar në këtë mënyrë duke u bazuar në nenin 80 të Ligjit të Punës. Gjykata në interpretim të këtij neni sqaron, se kjo dispozitë ligjore, është dispozitë autorizuese për gjykatën, kur e njëjta gjen se ndërprerja e marrëdhënies së punës është bërë në mënyrë të kundërligjshme. Bazuar në këtë nen, gjykata ka gjetur se ndërprerja e marrëdhënies së punës është bërë në mënyrë të kundërligjshme, andaj palës së paditur i bie barra e kompensimit për paditëses, për ndërprerjen e kundërligjshme të marrëdhënies së punës. Gjykata thekson se kjo dispozitë ligjore nuk flet në mënyrë eksplicite për paga, mirëpo flet për kompensim, shtesa dhe shuma të tjera të cilat i takojnë punonjësit në bazë të ligjit, kontratës së punës, aktit të brendshëm dhe kontratës kolektive. Se çfarë është kompensim, gjykata me këtë rast vlerëson se kemi të bëjmë me pagën të cilën e ka realizuar pala paditëse në momentin e marrëdhënies së punës, të paraparë me nenin 55 par.1 dhe 2 të Ligjit të Punës, kurse shtesa dhe shuma të tjera janë ato të cilat punëmarrësi i ka realizuar në momentin e ndërprerjes së marrëdhënies së punës, për periudhën kohore janari 2014 deri me janar 2019 ne pagën bruto prej 31.496,43 euro, nga e cila shumë ndalen në burim kontributi pensional në shumën prej 1,574,82 euro, që rezulton pagën neto në shumë prej 28.281.81 euro, e ku obligim i paditurës është që shumen prej 1.574,82 euro të përfundoj në Fondin e Trustit

pensional nga llogaria e punëdhënësit në të mirë të llogaris së paditësit, për çka edhe gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Gjykata vendimin për kamatën e ka mbështetur në dispozitën e nenit 382 të LMD-së, për dhe atë duke pasur parasysh se gjykata është e lidhur me kërkesat e palës paditës dhe e njëjta e ka kërkuar kamatën nga data e përpilimit të ekspertizës datë 27.11.2023, pasi që nga momenti kur pala paditëse ka kërkuar përmbushjen e obligimit dhe nga ky moment pala e paditur ka rënë në vonës.

Vendimin që e paditura ti bartë shpenzimet e procedurës, gjykata e ka mbështetur në dispozitat e nenit 449 dhe 452, 453, e lidhur me nenin 463 të LPK-së, duke mare parasysh suksesin e palës paditëse në këtë procedurë si dhe duke u mbështetur në tarifën e Odës së Avokatëve të Kosovës dhe atë shumen prej 1.498,00 euro, (lartësia e shpenzimeve të procedurës i referohen shpenzimeve të përfaqësimit të autorizuarit të palës paditëse dhe atë për: përpilimin e padisë shumen prej 208 euro, për ekspertizë financiare dhe plotësimin e saj shumen totale prej 250.00 euro, për pesë seanca të mbajtura për secilën nga $208.00 \times 5 = 1.040.00$ euro, dhe shumen 208 euro për precizimin e kërkesëpadisë). Ndërsa gjykata nuk i njohi shpenzimet e procedurës palës paditëse për dy parashtrësia mbi precizimin e padisë dhe se i përket lartësisë së kërkesë për shpenzime gjykata është e lidhur me krekës të palëve.

Nga të lartë cekurat u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, e konform nenit 143 të LPK-së.

GJYKATA THEMELORE PEJË
DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM – DIVIZIONI CIVIL
2019:289527 - C.nr. 2433/23, 02.04.2024

G j y q t a r i
Besnik Shala

Këshilla juridike:

Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa, në afat prej 7 dite, nga dita e marrjes, në Gjykatën e Apelit në Prishtinë, e nëpërmes kësaj gjykate.